

VENDIM
Nr. 108, datë 2.7.2020

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 187, DATË 10.11.2017, “PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALBGAZ” SHA, NË AKTIVITETIN E SHPËRNDARJES SË GAZIT NATYROR”, TË NDRYSHUAR, DHE NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 188, DATË 10.11.2017, “PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALBGAZ” SHA, NË AKTIVITETIN E TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 16, pika 12; të neneve 46 dhe 56, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”; të nenit 53, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 2.7.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 78/1 prot., datë 23.6.2020, “Mbi një ndryshim në vendimet e Bordit të ERE-s nr. 187 dhe nr. 188, datë 10.11.2017”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 220, datë 20.12.2019, vendosi:

1. Të miratojë ndryshimin e pikës 1, të vendimit nr. 187, datë 10.11.2017, si më poshtë:
- “Të licencojë shoqërinë “Albgaz” sh.a., në veprimtarinë e shpërndarjes së gazit natyror, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që brenda datës 20.6.2020, në mbështetje të nenit 24, pika 2 e ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të plotësojë të gjithë dokumentacionin e munguar...”

2. Të miratojë ndryshimin e pikës 1, të vendimit nr. 188, datë 10.11.2017, si më poshtë:

- “Të licencojë shoqërinë “Albgaz” sh.a., në veprimtarinë e transmetimit të gazit natyror, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që brenda datës 20.6.2020, në mbështetje të nenit 24, pika 2, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të plotësojë të gjithë dokumentacionin e munguar...”

- Në ERE ka mbërritur shkresa e shoqërisë “Albgaz” sh.a., nr. 121 prot., datë 16.6.2020, protokolluar në ERE me nr. 85 prot., datë 18.6.2020, “Kërkesë për shtyrje afati të vendimit mbi licencimin e shoqërisë ‘Albgaz’ sh.a.”, nëpërmjet së cilës shoqëria ka paraqitur kërkesën për shtyrje të afatit të dërgimit të dokumentacionit të munguar deri në datën 20.12.2020.

- Kjo kërkesë vjen në referim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 243, datë 4.3.2020, për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në të gjithë Republikën e Shqipërisë.

- Kërkesa e Shoqërisë për shtyrje të afatit të depozitimit të dokumentacionit të nevojshëm është depozituar përpara përfundimit të afatit të vendosur në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 220, datë 20.12.2019 dhe duke marrë parasysh të gjitha kufizimet e vendosura gjatë kësaj periudhe me qëllim parandalimin e përhapjes së epidemisë së shkaktuar nga virusi COVID-19, vlerësojmë se shoqëria ndodhet në kushtet e pamundësisë për të siguruar dokumentacionin e nevojshëm.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin e pikës 1, të vendimit nr. 187, datë 10.11.2017, si më poshtë:

“Të licencojë shoqërinë “Albgaz” sh.a., në veprimtarinë e shpërndarjes së gazit natyror, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që brenda datës 20.12.2020, në mbështetje të nenit 24, pika 2, e ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të plotësojë të gjithë dokumentacionin e munguar.

2. Të miratojë ndryshimin e pikës 1, të vendimit nr. 188, datë 10.11.2017, si më poshtë:

“Të licencojë shoqërinë ‘Albgaz’ sh.a., në veprimtarinë e transmetimit të gazit natyror, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që brenda datës 20.12.2020, në mbështetje të nenit 24, pika 2, e ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të plotësojë të gjithë dokumentacionin e munguar.

3. Drejtoria e Çështjeve Ligjore të njoftojë shoqërinë “Albgaz” sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti